



Republika e Kosovës

Komuna Drenas

Zyra e Kryetarit

01Nr. 030-72500 datë 23.12.2019

Raporti i punës nga ZBGj Drenas Janar - Dhjetor 2019

ZBGJ/Komuna Drenas duke u bazuar në kërkesën e datës 12.12.2019, për dorëzimin e raportit janar-dhjetor 2019 Agjencisë për Barazi Gjinore lidhur me raportimin e Komunave, përkatësisht Zyrtarëve për Barazi Gjinore, bën këtë raport të punës të realizuar për vitin 2019.

Me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur një takim i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me të gjitha punonjëset e administratës komunale, të cilave iu janë dhuruar edhe buqeta me lule. Gjatë këtij takimi Kryetari Lladrovci ka theksuar se Komuna e Drenasit mbetet komunë lidere sa i përket besimit në aftësitë dhe shkathtësitë e grave, ku 6 nga gjithsej 12 drejtori udhëhiqen nga gratë/femrat, ndërsa pjesa dërrmuese e stafit të administratës komunale janë femra.

ZBGJ-Drenas/Gllogoc me ftesë të Ekipi i OSBE-se përkatësisht z.Driton Nuli në ambientet e Komunës së Drenasit/Gllogocit ka mbajtur takim lidhur me Pytesore "Monitorimi i Ligjit per Barazinë Gjinore". Gjatë këtij takimi është diskutuar për Strategjitetë dhe planet e veprimit të cilat i zbaton Komuna për të promovuar Barazinë Gjinore, sigurimin e integrimit gjinor të politikave,

buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, përbërjen gjinore të Kuvendit Komunal, përbërja gjinore e Komitetit të Komuniteteve etj.

ZBGJ-Drenas/Gllogoc gjatë kësaj periudhe raportuese janar – dhjetor 2019 ka marrë pjesë në prezantimin e manualit “ Parandalimi i Stereotipave Gjinorë dhe Promovimi i Barazisë Gjinore në Tekstet dhe Materialet Shkollorë” i organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore me datë 06 qershor 2019, manual ky i cili synon të ofroj udhëzime konkrete për tekst-shkruesit, recezentet dhe vetë arsimtarët se si të integrojnë perspektivën gjinore, të sfidojnë marrëdhëniet gjinore të mbingarkuara me role të stereopitizuar gjinore, që mbajnë vajzat larg proceseve zhvillimore, vendimarrjes, zhvillimit të plotë intelektual dhe profesional dhe eliminimin e pasojave që pabarazia gjinore ka në jetën e individëve dhe shoqërisë në tërësi. Hapjen e këtij takimi e bëri Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edi Gusia, Këshilltari Politik i Ministrit të MASHT, Udhëheqësja e projektit NIRAS CPM International Blerinda Idrizi .



ZBGJ-Drenas/Gllogoc me rastin e vazhdimit te masës affirmative per regjistrimin e pronës së paluajteshme në emër të dy bashkëshorteve nga prilli i vitit 2019 deri ne prill te vitit 2020, me posterat të cilët i ka realizuar ABGJ i kemi vendosur në ambientet e Komunës së Drenasit më qëllim që qytetarët të jenë të informuar për regjistrimin e pronës së palujtshme në emër të dy bashkëshortëve.Gjatë vitit 2019 në Drejtoreni për Gjeodozi, Kadastër dhe Pronë si rezultat i vazhdimit të masës affirmative janë paraqitur 32 kërkesa për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve. ndërsa gjithsej nga viti 2019 janë 99 raste ku femrat në çfarëdo forme janë përfshirë në lidhje me pronën qoftë bartje, regjistrim pronësise në emër të grave, trashëgim etj.



“1 Qershori ” Dita ndërkontëtare e Fëmijëve. Me rastin e 1 Qershori Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Drenasit në bashkëpunim me Këshillin e Veprimit Rinor Lokal, policinë e Drenasit dhe Institucionin Parashkollor “Ardhmëria ” në Drenas shënuan 1 Qershori Ditën Ndërkontëtare të Fëmijëve . Në këtë ditë fëmijët patën mundësi që të shfaqin aftësitë e tyre në arte e aktivitete të ndryshme . Përveqse një ditë festive, në fakt 1 Qershori duhet të jetë edhe një ditë sensibilizimi për të ndalur abuzimin ndaj fëmijëve, sidomos angazhimin e tyre në punë kur janë ende të mitur.



Pjesëmarrja e ZBGJ/Drenas në Punëtorinë për harmonizim gjinor të nismave të sigurisë në bashkësi e organizuar nga OSCE Mission in Kosovo. Gjatë kësaj punëtorie u diskutua lidhur me Pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në nivel lokal dhe integrimi gjinor në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, Mbështetja e mekanizmave të sigurisë në komunitet për adresimin e çështjeve dhe shqetësimeve të sigurisë në komunitet, roli i Policisë së Kosovës në parandalimin e Dhunës me Bazë Gjinore (DHBGJ) dhe mbrojtja e viktimave të dhunës në familje, si dhe sfidat e të mbijetuarve të DHBGJ në programet e rehabilitimit dhe riintegrimit. Pjesëmarrës ishin Zëvendës Ambasadori i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Policia e Kosovës Major Vjollca Hoti, Znj Edi Gusia, Drejtoreshë ekzekutive, Agjacioni për Barazi Gjinore, përfaqësues nga Komitetet Lokale për Siguri në Bashkësi dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Komuna e Drenosit ka shënuar muajin e ndërgjegjesimit për kancerin e gjirit. Zyra për Barazi Gjinore Komuna Drenas në bashkëpunim me QPDG me Drejtoreshen Kadire Tahiraj dhe QKMF radiologun Shkelzen Gashi kemi mbajtur një sesion informues lidhur me kancerin e gjirit. Sesioni është hapur nga zyrtarja per barazi gjinore pastaj radiologu i cili në mënyrë më

të hollësishme ka informuar në hollësi lidhur me zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit dhe rëndësinë e shëndëtit lidhur me këtë sëmundje. Në këtë sesion informues përveq zyrtarëve nga Komuna kanë marrë pjesë edhe shoqëria civile. Numri i pjesëmarrësve ka qenë 47 femra. Gjithashtu të gjithë pjesëmarrësve iu është shpërndarë fjongo ngjyrë rozë e cila paraqet simbol ndërkombëtar të ndërgjegjësimit ndaj kancerit të gjirit dhe i mbështetjes së personave që vuanin nga kanceri i gjirit. Qëllimi i këtij sesioni informues ishte ndërgjegjësimi i qytetarëve për rrezikun nga kanceri i gjirit.



Me datë 30 tetor – 02 nëntor 2019 pjesmarrje në Projektin “Fuqizimi i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave institucionalë për barazi gjinore në Kosovë” të financuar nga Qeveria Suedeze – Sida, që drejtohet nga Konsorciumi Niras & CPM International organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore.

Zyra për Barazi Gjinore/Komuna Drenas ka marrë pjesë në Punëtorinë për përgatitjen e planit vjetor të integruar të punës për Zyrtar/e për Barazi Gjinore të nivelit komunal të mbajtur në Tiranë. Punëtoria është mbajtur në kuadër të zbatimit të planit të punës, Projekti “Fuqizimi i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave institucionale për barazi gjinore në Kosovë”

Gjatë kësaj punëtorie e cila është mbajtur në Tiranë së bashku me zyrtarët nga Komunat tjera, është shtjelluar Udhëzuesi mbi Sistemin e Integruar të planifikimit vjetor për Mekanizmat Gjinor në Kosovë. Ky udhëzues jep një pasqyrë gjithëpërfshirëse të përgjegjësive dhe roleve pozicionuese të Zyrtarëve për Barazi Gjinore. Në këtë punëtori u punua sipas agjendës së përgatitur nga Agjencia për Barazi Gjinore lidhur me përgatitjen e planit të integruar vjetor të punës për Zyrtarët e barazisë gjinore, plani i veprimit të PKBGJ-së instrumentet kryesore të kornizës së politikave për promovimin e barazisë gjinore, kalendar i ndërgjegjesimit dhe avokimit për gjininë dhe gratë, modeli i planifikimit vjetor etj.



Me datë 19.11.2019 pjesëmarrje në takimin nga Grupi për studime gjinore me znj. Merita Shala. Temë e këtij takimi ishte Pilot Indeksi për të drejtat pronësore të grave si dhe korniza ligjore e cila rregullon të drejtat pronësore të grave, vështirësitë të cilat hasin gratë/femrat në praktikë për realizimin e këtyre të drejtave. Edhe pse Kushtetuta e Kosovës garanton të drejta të barabarta në lidhje me trashëgiminë dhe Ligji për trashëgiminë u jep grave dhe burrave të drejta të barabarta të trashëgimisë, kur vjen puna tek çështjet trashëgimore, zakonet tradicionale i jepin përparësi mashkullit para femrës. Në këtë takim pjesëmarres ishin edhe

zyrtare nga Drejtoria për Gjeodozi Kadastër dhe pronë /Komuna Drenas, Avokatë, Organizata jo qeveritare për të Drejtat e Grave QPDG etj.



Lidhur me fushatën “16 Ditët e Aktivizimit kundër dhunës në familje” Komuna e Drenasit përkatësisht Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me zyrtarët nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka realizuar aktivitet lidhur më këtë fushatë ku ka shpërndarë postër nëpër institucionale komunale lidhur me vetëdijëmin për dhunën në familje. Qyetarëve u janë shpërndarë broshura në të cilat është dhënë mesazh për parandalimin e dhunës në familje, është përashkruar legjislacioni i cili rregullon dhunën në familje si dhe institucionet ku mund të kërkojnë ndihmë nëse janë viktima të dhunës në familje. Gjishashtu në Qendrën për Punë Sociale me drejtorin e kësaj qendre dhe zyrtaret e shërbimeve sociale është mbajtur takim lidhur me ndihmën të cilën e ofrojnë ata për viktimat e dhunës në familje, me cilat vështiresi dhe sfida përballen gjatë punës së tyre lidhur me këto raste.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe lidhur me rastet të cilat janë trajtuar nga Organi i Kujdestarisë i QPS-së ku gjatë vitit 2019 ka trajtuar rastet e dhunës në familje me çrast ka

ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për këtë kategori. Gjithsej kanë trajtuar 20 raste të dhunës në familje. 15 raste kanë qenë dhunë fizike e ushtruar nga burri, 4 dhunë psikologjike dhe 1 rast dhunë seksuale. Gjithashtu gjatë vitit 2019 Organi i Kujdestarisë ka arritur që të sanoj gjendjen e 4 rasteve të dhunës në familje.

**25 Nëntori –
Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e
Dhunës në Familje**

**16 Ditë
të Aktivizimit
kundër dhunës
në familje**

25 Nëntor – 10 Dhjetor

**Dhuna në familje
është krim
dhe dënöhët!**

Kapoeto dhunën!
TIRKOR;
Mbrojtja viktimave, Prishtina;
Tel mobil: 044-278-738

Numbri BKC: 0800 11 112
Tel: 192 ose 92 - 038-584-092
Email: info@kosovopolice.com



REPUBLIKA E KOSOVËS
Kosova e Drejtë

**Unë zgjedh të jetoj
PA DHUNË!**



Organizator i kësaj
Tirana & Kryeqyteti - Zjedotja për Shëndetin Gjinore
ne Kosovë/Maqetas me: Dërgatoret e Zvillimit i Elektromjekit

Drejtoria Komunale e Arsimit-DKA Komuna e Drenasit gjatë vitit 2019 ka ndarë 40 bursa për nxënës të shkollave të mesme dhe 160 të tjera për student të universiteteve ku prej tyre 127 bursa u janë ndarë femrave dhe 33 meshkujve. Studentët përfitues të bursës komunale për vitin akademik 2019/2020 kanë nënshkruar kontratat për marrjen e burses të ndara nga Komuna në vlerë prej 500 € për një student. Me rastin e nënshkrimit të kontratave, morën pjesë kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkyryetari Nazmi Hasi si dhe anëtarët e komisionit të cilët kanë bërë vlerësimin e aplikuesve për bursë.



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik/DZHE /Komuna e Drenasit në bashkëpunim me AZHR-në ka mbajtur trajnimin “Fuqizimi i të rinjve dhe grave në aftësi të buta dhe aftësi menaxheriale”. Në këtë trajnim pjesëmarrësit janë trajnuar në mënyrë profesionale rreth aftësive të buta dhe atyre menaxheriale. Në këtë trajnim kanë marrëpjesë Kryetari i Komunës, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Gratë nga Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, të rinjtë nga

Qendra Rinore, nga Zyra e Entit të Punësimit dhe qytetarë. Përfitues t të këtij trajnimi kanë qenë 27 persona, prej tyre 17 kanë qenë femra dhe 10 meshkuj.

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural /Komuna e Drenasit gjatë vitit 2019 ka përkrahur fermerët e Komunës së Drenasit. Kjo drejtori ka ndarë 100 motokultivatorë për fermerët e Komunës së Drenasit. Këto pajisje do të ndikojnë në lehtësimin e punës së fermerëve dhe do të rrisin efikasitetin në kultivimin e pemëve dhe perimeve si dhe do të ndikojnë në zgjerimin e sipërfaqeve .Në mesin e përfituesve të këtyre motokultivatorëve 11 prej tyre janë femra .Gjithashtu nga kjo Drejtori kanë përfituar edhe 93 fermerëme me serra prej tyre 24 përfituese janë femra dhe 69 meshkuj. Gjithashtu IADK-ja ka përkrahur 7 fermer të Komunës së Drenasit me motokultivatorë në kuadër të projektit për bimë mjekësore dhe aromatike të cilët kanë përfituar motokultivatorë të madhësive të ndryshme me frezë dhe kositëse.



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë viti 2019 ka mbështetur me subvencione OJQ “Bliri” për realizimin e aktiviteteve. Kjo OJQ udhëhiqet nga znj. Mahije Smajli e cila më anë të këtij subvencionii ka realizuar panair 2 ditor për promovimin e produkteve tradiacionale. Qëllimi i këtij panairi ka qenë fuqizimi ekonomik i grave në biznese, artizanale tradicionale përpunimin e pemëve, kultivimin e mjaltit dhe përpunimi i drurit.

Për realizimin e aktiviteteve për të rinxjtë është mbështetur edhe OJQ Këshilli i veprimit rinor lokal në Drenas. Lista e OJQ-ve dhe Individ që të tjerë kanë përfituar Subvencione nga DKRS për vitin 2019 në formë direkte ose involvuese ishin gratë/vajzat janë edhe OJQ. KV. “Feronikeli”(Femrat), OJQ. KF. “ Feronikeli ” (në kuadër të së cilisë është edhe klub i futboolit i femrave) OJQ. KV. “ Gryka ” (Femrat), OJQ-Këshilli i Veprimit Rinor Lokal 50-50% Meshkuj-Femra OJQ. SHKA” Shote Galica” 50-50% Meshkuj-Femra, OJQ. SHKA “Shqipet e Drenicës ” - 50-50% Meshkuj-Femra, OJQ. SHKA” Ymer Alushani ” - 50-50% Meshkuj-Femra, Individ - Dafina Leku (F), OJQ “Panajot Kanaqi” (aktivitet në të cilin përfituar të dy gjinitë), Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës etj.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale /Komuna Drenas ka subvencionuar Shoqatën e Personave me aftësi të kufizuara “HANDIKOS” si dhe OJQ Shqipet e Drenicës “Festival për fëmijët me nevoja të veçanta”.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor Komuna e Drenasit është vlerësuar për përfaqësimin gjinor në nivel lokal nga MAPL-ja. Kryetari Lladrovci me datë 11.12.2019 ka pranuar certifikatën nga MAPL-ja për arritjen e përfaqësimit gjinor në nivel lokal dhe mundësinë e pjesëmarries së grave në vendimarrje “Në vlerësim të përpjekjeve të bëra dhe për kontributin e drejtë barazisë gjinore në Komunën e Glogocit”. Ky vlerësim nga MAPL-ja Komunës së Drenasit i është bërë në kuadër të “Përfaqësimit gjinor në nivel local -2 vite pas zgjedhjeve lokale dhe Kryetari Lladrovci është vlerësuar me performansën më të mire bazuar në indikatorët e përformances gjinore .

Përveq kësaj Komuna e Drenasit është shpërblyer edhe me dy çmime, me "Çmimin për arritje në fushën e përfaqësimit të barabartë gjinor në vitin 2018" si dhe me "Çmimin për përformansën më të mire komunale për vitin 2018".



E autorizuar
Gentjanë Morina, ZBGJ Drenas